

U D H Ë Z I M
Nr.2, datë 11.7.1994

PËR KOMPETENCAT DHE DETYRAT E DREJTORIVE ARSIMORE NË RRETHE

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

1. Në përbërje të drejtorisë arsimore të rrethit, brenda numrit ekzistues të punonjësve, krijohet sektori ekonomik. Përgjegjësi i sektorit ekonomik është në emërtesën e Ministrisë së Arsimit.

2. Drejtoria arsimore në rreth kryen edhe këto detyra:

- Ndhmon bashkitë dhe komunat për të siguruar kushtet e nevojshme për funksionimin normal të institucioneve lokale të arsimit dhe vlerëson e ndihmon në parashikimin drejt të kërkesave të tyre ekonomike e financiare. Merr të dhënat e parashikimeve vjetore të treguesve ekonomikë e financiarë nga bashkitë e komunat, të cilat, pas përpunimit dhe argumentimit, i dërgon në Ministrinë e Arsimit në afatet e caktuara.

- Në bashkëpunim me institucionet arsimore, këshillat e bashkive e të komunave, studion, parashikon dhe ndjek drejtpërdrejt kryerjen e investimeve; rikonstruksionet, ndërtimet, pajisjet, makineritë e sistemit të arsimit, të cilat miratohen nga Ministria e Arsimit.

- Përcakton, në bashkëpunim me institucionet arsimore, nevojat për tekste shkollore (në tituj e sasi), artikuj shkollorë, regjistra, dëftesa, amëza etj., duke bërë kërkesë për to në Ndërmarrjen e Librit Shkollor në afatet e caktuara.

- Bashkëpunon me institucionet arsimore për të përcaktuar nevojat për mjete e pajisje mësimore, shkumësa, materiale sportive, pajisje laborator, kimikate, qelqurina për zhvillimin e procesit mësimor, bën kërkesa për to në ndërmarrjet prodhuese ose subjekte private, duke zbatuar aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave dhe të Ministrisë së Arsimit, si dhe bën shpërndarjen e tyre për çdo institucion arsimor.

- Organizon shpërndarjen e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, pajisjeve e orendive të tjera shkollore, regjistrave, dëftesave, shkumësive e materialeve të tjera, që sigurohen në mënyrë të përqendruar nga Drejtoria Arsimore dhe shpërndahen për çdo shkollë e institucion tjetër arsimor.

- Organizon transportin e mësuesve që punojnë larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, në përputhje me fondet buxhetore të miratuara për këtë qëllim.

- Studion, parashikon dhe kryen të gjitha shpenzimet e Drejtorisë Arsimore dhe organizon mbajtjen e evidencës kontabël, duke përpiluar dhënien e llogarisë periodike dhe vjetore në afatet e caktuara.

- Bashkitë dhe komunat, në përputhje me fondet buxhetore të miratuara mund t'i vënë në dispozicion Drejtorisë Arsimore këto fonde për të blerë në shkallë rrethi artikuj të caktuar, si banka, tavolina, karrige, xhama, krevate, dyshekë, batanie, soba, çarçafë e bojëra të ndryshme. Drejtoria Arsimore merr të gjitha masat për plotësimin e kërkesave për këto materiale kryesore, duke i siguruar në mënyrë të përqendruar me efektivitet më të lartë ekonomik. Ajo organizon shpërndarjen e tyre për çdo bashki e komunë, në përputhje me fondet e parashikuara nga ato.

- Merr të dhëna për realizimin e treguesve arsimorë, ekonomikë e financiarë të miratuar nga organet përkatëse për shkollat, institucionet arsimore, komunat e bashkitë, bën përmbledhësen në shkallë rrethi, në përputhje me evidencat statistikore të miratuara dhe raporton në afatet e caktuara në Ministrinë e Arsimit.

- Në bashkëpunim me bashkitë, komunat e institucionet arsimore, organizon studime për gjendjen e institucioneve arsimore të rrethit (kopshte, shkolla 8-vjeçare, qendra kulturore të fëmijëve) dhe mundësinë e ndryshimit të kësaj strukture në vartësi nga aftësia e tyre për të realizuar detyrimin shkollor, sipas veçorive demografike, terreneve, klimës, transportit e në tërësi infrastrukturës që ka rrethi.

- Për zhvillimin e arsimit të mesëm, në bashkëpunim me bashkitë e komunat, Drejtoria Arsimore ndërmerr studime për çeljen ose mbylljen e profileve të shkollave të mesme, në përshtatje me planet e zhvillimit ekonomik e kulturor të rrethit dhe kushtet e tjera për efektivitetin e këtij lloji arsimi.

Studimet e kryera sipas përkatësisë shqyrtohen në mbledhjen e këshillit të bashkisë, komunës ose rrethit dhe i paraqiten nga Drejtoria Arsimore për miratim Ministrisë së Arsimit.

- Për shkollat e mesme kombëtare që pranojnë nxënës me konkurs, bën njoftimet përkatëse në të gjitha shkollat 8-vjeçare të rrethit dhe dërgon në shkollat që të bëhet konkursi listat e nxënësve konkurrues, sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Arsimit. Për zhvillimin e konkurseve ose pranimeve me plan, Drejtoria Arsimore bashkëpunon me bashkitë, komunat dhe drejtoritë e shkollave.

- Ndhmon aparatin e bashkive dhe komunave për trajtimin e problemeve që lidhen me miratimin e bursave e të gjysmëbursave të nxënësve e studentëve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit.

- Duke u mbështetur në planin e bursave e të gjysmëbursave për nxënësit dhe studentët që i ka dërguar Ministria e Arsimit, bën shpërndarjen e tyre për çdo bashki e komunë. Vendimi i këshillit të bashkisë ose komunës paraqitet nga nxënësi dhe studenti në shkollat ku ka fituar të drejtën e studimit.

Në bashkëpunim me bashkitë dhe komunat, ndjek në shkallë rrethi realizimin e detyrimit shkollor dhe, me propozimin e drejtorive të shkollave, miraton përjashtimin e nxënësve nga detyrimi shkollor.

3. Struktura, organika dhe pagat e punonjësve të Drejtorisë Arsimore caktohen nga Ministria e Arsimit.

4. Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.9, datë 3.9.1993, kreu II "Për detyrat që kryen Qendra Ekonomike e Arsimit" dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.500, datë 18.10.1993 "Për kompetencat e zyrave të arsimit të rretheve", shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi